



8 SHKURT 2015

## CFARË DUHET MBAJTUR MEND NGA RASTI JABLLANOVIQ?

Më 3 shkurt, Kryeministri Isa Mustafa deklaroi se Ministri për Komunitete dhe Kthim, Aleksandar Jabllanoviq, nuk është më pjesë e Qeverisë, në prag të një proteste të re që ishte paralajmëruar të mbahej më 4 shkurt. Si rezultat i kësaj, protesta është pezulluar për momentin. Jabllanoviq që kritikuar ashpër nga një numër i madh i partive politike, organizatave joqeveritare, mediave dhe publiku i gjerë pasi ai i quajti 'egërsira' anëtarët e një organizate të të afërmeve të personave të zhdukur të cilët kishin bllokuar hyrjen e Kishës Ortodokse në Gjakovë ndërsa po protestonin ardhjen e serbëve për të marrë pjesë në lutjet e Krishtlindjeve. Në të njëjtën kohë, ministrat nga Lista Serbe ('Srpska lista') në Qeveri kanë qenë cak i kritikave që prej krijimit të Qeverisë së re të Kosovës, në dhjetor 2014, për shkak të deklaratave të tyre që tregojnë se ata injorojnë ose nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, në përputhje me qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Serbisë. Më 24 janar, një numër i madh njerëzish morën pjesë në një protestë të thirrur nga Vetëvendosja, AAK, dhe Nisma për Kosovën, të cilët kërkuan dorëheqjen e Jabllanoviqit dhe miratimin e një ligji të ri për Ndërmarrjet Publike përmes të cilit do të shtetëzohej kompleksi i minierave Trepça. Në një protestë pasuese, më 27 shkurt, shpërthyen përleshje të dhunshme në mes të protestuesve dhe Policisë së Kosovës.

Mbetet e paqartë se çfarë do të jetë rezultati i vendimit të Mustafës për shkarkimin e Jabllanoviqit në pjesëmarrjen e vazhdueshme të Listës Serbe në Qeveri. Të enjten, më 5 shkurt, Jabllanoviq dhe ministrat e tjerë të Listës Serbe u takuan në Beograd me Kryeministrin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe Marko Gjuriqin, Drejtorin e Zyrës së Qeverisë së Serbisë për Kosovë dhe Metohi. Në këtë takim u ra dakord që një vendim mbi pjesëmarrjen e vazhdueshme të Listës Serbe në Qeverinë e Kosovës do të merret pasi të rifillojnë negociatat ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, në Bruksel, më 9 shkurt. Gjuriq dhe Jabllanoviq dënuan ashpër shkarkimin e Jabllanoviqit si vendim të nxituar dhe të politizuar i cili nuk ka pasur kurrfarë lidhje me deklaratën e Jabllanoviqit, i cili nuk i drejtohej komunitetit shqiptar në Kosovë, por vetëm atyre të cilët kishin bllokuar me dhunë hyrjen të Kishës Ortodokse në Gjakovë.<sup>1</sup> Në të njëjtën kohë, Gjuriq interpretoi shkarkimin e Jabllanoviqit përgjatë linjave etno-kombëtare, duke argumentuar se ky përbënte një poshtërim të Listës Serbe që është i drejtuar ndaj tërë komunitetit serb në Kosovë.<sup>2</sup>

Çfarëdo që të jetë rezultati i këtyre zhvillimeve, kundërshtitë në linja etnike rreth Jabllanoviqit tregojnë se tensionet me baza kombëtare në politikë lehtë mund të mobilizojnë popullsinë e gjerë si rast për të nxjerrë në shesh frustrimet më të gjera me gjendjen e varfër socio-ekonomike dhe perspektivat dhe perceptimin për korrupsionin e përhapur. Është e vërtetë se ka pasur disa zëra të

<sup>1</sup> [http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=02&dd=05&nav\\_category=640&nav\\_id=954971;http://koha.net/?id=27&l=43695](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=02&dd=05&nav_category=640&nav_id=954971;http://koha.net/?id=27&l=43695)

<sup>2</sup> [http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=02&dd=05&nav\\_category=640&nav\\_id=955181](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=02&dd=05&nav_category=640&nav_id=955181)

cilët kanë argumentuar se duhet të bëhet një dallim ndërmjet deklaratave të Jabllanoviqit dhe komunitetit serb në Kosovë, në përgjithësi.<sup>3</sup> Gjithashtu ka edhe përfaqësues të serbëve të Kosovës të cilët kanë argumentuar se Jabllanoviq duhet të jepte dorëheqjen pasi që deklarata e tij ka ofenduar shumë shqiptarë dhe se Qeveria duhet të fokusohet në zgjidhjen e problemeve që prekin jetën e përditshme të qytetarëve.<sup>4</sup> Megjithatë, në demonstratat dhe protestat e muajit të kaluar janë vënë re haptazi tensione të përgjithshme etnike shqiptare-serbe. Fakti që njerëzit nuk kishin dalë në rrugë për të demonstruar gjatë bllokimit politik të vitit të kaluar rreth formimit të qeverisë, apo për të shprehur pakënaqësinë e tyre me gjendjen socio-ekonomike në Kosovë, por kanë zgjedhur të demonstrojnë ndaj tensioneve shqiptaro-serbe në Qeverinë e Kosovës dhe në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, tregon shumë. Konfrontimi etno-kombëtar është gjithashtu evident në reagimin e zyrtarëve të Beogradit ndaj shkarkimit të Jabllanoviqit. Këto tensione etnike në rritje mund të dëmtojnë të arriturat e deritashme në lidhje me harmonizimin dhe integrimin e komunitetit serb në Kosovë. Kjo gjendje i bën të cenueshëm në veçanti pjesëtarët e komunitetit serb që jetojnë në pjesën në jug të lumit Ibër, ndonëse është inkurajuese se nuk është raportuar asnjë incident ndëretnike gjatë kësaj periudhe konfrontimesh politike.

Marrë parasysh rritjen shpërthyesë të tensioneve etnike në kontekstin e polemikave rreth Ministrin Jabllanoviq, Qeveria duhet të ndërmarrë masa që të parandalojë që mosmarrëveshjet e brendshme në Qeveri të marrin përmasa publike përgjatë linjave etnike. Mungesa e koherencës dhe konfrontimet politike që i kanosen Qeverisë nga brenda jo vetëm që krijojnë konfrontime etnike që mund të jenë shumë të dëmshme për harmonizimin shqiptaro-serb brenda Kosovës, por ato gjithashtu janë shumë joproduktive për punën e Qeverisë në një periudhë vendimtare në përpjekjet e Kosovës për integrim evropian dhe stabilizimin e brendshëm. Qeveria e re zor të ketë marrë ndonjë vendim që nga formimi i saj, ndërsa vendi pothuaj po rrëshqiste në prag të trazirave civile. Përveç kësaj, komunitetet e tjera kanë qenë të marginalizuar në debatin në vazhdim e sipër rreth marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve dhe proceset përkatëse, i cili është përqendruar tërësisht mbi marrëdhëniet dhe konfrontimet shqiptaro-serbe.

Partnerët e koalicionit, LDK-PDK dhe Lista Serbe, duhet të bien dakord mbi një sërë parimesh të cilat do t'i hapin rrugën një mjedisi punues të koordinuar dhe të bazuar në konsensus ndërmjet përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre serbë në Qeverinë e Kosovës, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme politike që mbajnë anëtarët e saj ndaj statusit të Kosovës. Baza e një marrëveshjeje të tillë pune duhet të jetë një dallim i qartë ndërmjet aspiratave politike të secilit ministri dhe zyrtari të Qeverisë si anëtarë të partive të tyre politike, dhe punës e deklaratave të tyre në cilësinë e krerëve të institucioneve që ata/ato përfaqësojnë ligjërisht dhe si anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Përfaqësuesit serbë në Qeverinë e Kosovës duhet të përmbahen veçanërisht nga dhënia e deklaratave për çështjen e madhe të statusit të Kosovës dhe marrëdhëniet e saj me Serbinë. Kjo çështje duhet të trajtohet si pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, e jo të bëhet çështje e mosmarrëveshjeve të brendshme në kuadër të institucioneve të Kosovës. Për më tepër, deklaratat të cilat qoftë edhe vetëm tërthorazi ose simbolikisht prekin çështjen e statusit të Kosovës janë treguar joproduktive për trajtimin e shumë problemeve konkrete e të prekshme me të cilat përballlet komuniteti serb dhe komunitetet e tjera në Kosovë dhe për të cilat ka prirje që të merren vendime, si kushtet socio-ekonomike, qasja në sundimin e së drejtës dhe në kujdes shëndetësor cilësor, punësimi i të diplomuarve nga institucionet arsimore të Serbisë që kanë funksionuar në Kosovë dhe stimujt për kontakte dhe shprehje në fushën e kulturës.

<sup>3</sup> <http://www.gazetaexpress.com/oped/pranvera-e-arabeve-te-prishtines-77694/>; <http://koha.net/?id=31&o=508>.

<sup>4</sup> [http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=01&dd=29&nav\\_category=640&nav\\_id=952532](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=01&dd=29&nav_category=640&nav_id=952532).

## Analiza dhe raporte të tjera politike:

[ECMI Kosova fton për arsye dhe veprim pas protestave në Prishtinë](#)

**25 janar 2015**

<http://goo.gl/BUFXp9>

[Farkimi i një mjedisi pune brenda Qeverisë së Kosovës](#)

**19 janar 2015**

<http://goo.gl/fqTYG5>

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes së Kishës Ortodokse Serbe në Gjakovë](#)

**7 janar 2015**

<http://goo.gl/RQZ5A1>

[Përmbledhje politike: qeveria e re, përfaqësimi i komuniteteve minoritare dhe sfidat përpara](#)

**10 dhjetor 2014**

<http://goo.gl/ztDfOI>

[Një vështrim mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë](#)

**4 nëntor 2014**

<http://goo.gl/3RyIIc>

[Komunitetet pakicë duan të shohin fundin e ngërçit politik](#)

**23 tetor 2014**

<http://goo.gl/sBf53x>

[Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)

**31 korrik 2014**

<http://goo.gl/sSc7dn>

[ECMI Kosova bën thirrje për qetësi në në përballje me përshkallëzimin e tensioneve etnike pas ndeshjes së futbollit Serbi-Shqipëri](#)

**15 tetor 2014**

<http://goo.gl/88dOMR>

[Përngjitja e ndarjes: themelimi i një Bordi të përbashkët për qytetin e Mitrovicës](#)

**27 qershor 2014**

<http://goo.gl/d6XKws>

[Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: një shikim i çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prak të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)

**2 qershor 2014**

<http://goo.gl/qlrHmd>

[Pasqyrë e disa ndryshimeve në Projektligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#)

**17 prill 2014**

<http://goo.gl/nufjM0>

[Drejhtësia kalimtare, të drejtat e njeriut dhe komunitetet në Kosovë](#)

**28 mars 2014**

<http://goo.gl/tjQJcF>

[Zgjedhjet lokale të vitit 2013 në Kosovë: mësimet e nxjerra për komunitetet minoritare](#)

**20 dhjetor 2013**

<http://goo.gl/p2MmME>

# POLICY BRIEF

Për më tepër informata, ju lutemi kontaktoni:

ECMI Kosova

Tel: + 381 (0) 38 224 473

Email: [info@ecmikosovo.org](mailto:info@ecmikosovo.org)

Ueb-faqja: [www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org)

## Rreth ECMI Kosovws

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.